



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 111, datë 27.10.2022

PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË APARATIT TË
BASHKISË SË DurrësIT

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, e nenit 54 shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 2, shkronja “c” dhe nenit 5 të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afat mesëm 2022-2024”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët, nëpunësit civilë, punonjësit administrativë të Aparatit të Bashkisë së Durrësit si dhe punonjësit e Policisë Bashkiake detajuar si mëposhtë vijon:

1.1. Miratimin e pagave për funksionarët, nëpunësit civilë, punonjësit administrativë të Aparatit të Bashkisë së Durrësit, sipas lidhjes nr. 2 të VKM nr. 625, datë 28.09.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

| | |
|--------------------------------------|--------------|
| 1. Kryetari i Bashkisë | 162.750 lekë |
| 2. Nën/kryetar | 138.000 lekë |
| 3. Këshilltarë të Këshillit Bashkiak | 16.275 lekë |
| 4. Drejtor i Kabinetit | 85.000 lekë |
| 5. Sekretar i Këshillit Bashkiak | 85.000 lekë |
| 6. Drejtor Drejtorie | 85.000 lekë |
| 7. Zëdhënës shtypi | 68.700 lekë |
| 8. Përgjegjës sektori | 74.700 lekë |
| 9. Specialist | 65.200 lekë |
| 10. Specialist prane MZSH | 65.200 lekë |
| 11. Këshilltarë të kryetarit | 34.000 lekë |

1.2. Miratimin e pagave për punonjësit e Policisë Bashkiake sipas lidhjes nr. 8 të VKM nr.625, datë 28.09.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

| | |
|-------------------|-------------|
| 1. Kryeinspektori | 84.700 lekë |
| 2 Inspektor | 61.300 lekë |
| 3. Polic bashkiak | 54.900 lekë |

1.3. Miratimin e pagave për administratorët e Lagjeve dhe Njësive Administrative si më poshtë vijon:

| | |
|--------------------------------|-------------|
| 1. Lagja nr.1 | 90.000 lekë |
| 2. Lagja nr.2 | 90.000 lekë |
| 3. Lagja nr.3 | 85.000 lekë |
| 4. Lagja nr.4 | 90.000 lekë |
| 5. Lagja nr.5 | 90.000 lekë |
| 6. Lagja nr.6 | 90.000 lekë |
| 7. Njësia Administrative Sukth | 85.000 lekë |

| | |
|--|-------------|
| 8. Njësia Administrative Manëz | 75.000 lekë |
| 9. Njësia Administrative Ishëm | 75.000 lekë |
| 10. Njësia Administrative Katundi i ri | 75.000 lekë |
| 11. Njësia Administrative Rrashbull | 61.500 lekë |
| 12. Punonjës administrativë * | 41.700 lekë |
| 13. Punonjës administrativë të arkivës | 34.000 lekë |

* Punonjës administrativë (roje, mirëmbajtës, shofer, magazinier, inspektor tregu, punonjës pastrimi).

- 1.4. Masteri Profesional i përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike do të paguhet sipas grupit të diplomës 1 (14.000 lekë).
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij Vendimi fillojnë nga data 1 shtator 2022 dhe përballohen nga fondet e lira të krijuara si pasojë e vakancave të vitit 2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Drejtorja e Buxhetit dhe Drejtorja Ekonomike.
4. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 568, datë 20.12.2018 “Për miratimin e kategorisë së pagës për funksionarët e zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Durrës”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 28.10.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 834/prot.
12

Durrës, më 03.11.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.111 datë 27.10.2022

“Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit të Bashkisë së Durrësit”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

